



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE  
BORDI**

**VENDIM**

**Nr. 80, datë 24.04.2019**

**PËR**

**MIRATIMIN E SHITESËS DHE DISA NDRYSHIMEVE NË RREGULLOREN NR. 120,  
DATË 02.10.2010 “PËR LICENCIMIN DHE MBIKËQYRJEN E BURSËS SË TITUJVE”,  
E NDRYSHUAR**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 22, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, të nenit 78, të ligjit nr. 9879, datë 21.02.2008 “Për titujt” me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes së Tregut të Kapitaleve dhe Fondeve, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

**V E N D O S I:**

I. Miratimin e shtesës dhe ndryshimeve në Rregulloren nr. 120, datë 02.10.2010 “Për licencimin dhe mbikëqyrjen e Bursës së Titujve”, e ndryshuar, si vijojnë:

1. Në nenin 17:

- i. Në pikën 1/b, hiqet shprehja “dhe çdo akt tjetër të bursës”;
- ii. Në pikën 2, hiqet shprehja “dhe akteve të tjera” dhe shprehja “dhe akteve”;
- iii. Në pikën 3, hiqet shprehja “dhe aktet e tjera”;
- iv. Pas pikës 3, shtohet paragrafi 3/1 me këtë përmbajtje:

“Bursa depoziton në Autoritet çdo akt që ka lidhje me rregullat e përcaktuara në pikën 1/b të këtij neni, si dhe çdo ndryshim të tij, brenda 15 ditëve nga miratimi i aktit nga organi kompetent i Bursës”.

II. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes së Tregut të Kapitaleve dhe Fondeve, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR**

**Pajtim MELANI**

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV**

**Ervin KOÇI**